



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:050972
Datë: 29.03.2021
Numri i dokumentit: 01642365

C.nr.1012/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Berat Spahiu, me bashkëpunatoren profesionale Gentiana Shabani, në çështjen juridike të paditëses A. Z nga fshati ..., Komuna e Gjilanit, të cilën e përfaqëson me autorizim Av. Milot Spahiu nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, të cilën me autorizim e përfaqëson Burim Maliqi, Zyrtar Ligjor në Zyrën e Avokatit të Komunës së Gjilanit, me objekt kontesti kompensimi i pagës jubilarë dhe shpenzimeve të ushqimit, vlera e objektit: 1,798.84 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe jopublik /për shkak të pandemisë Covid -19/ të mbajtur me datë 26.03.2021, merr këtë;

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet si e bazuar me ligj, kërkesëpadia e paditëses A. Z nga fshati ..., Komuna e Gjilanit dhe detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit, që paditëses t'ia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 210.50 €, në emër të shpërblimit jubilar, në emër të kompensimit të shujtave të ushqimit në lartësi prej 1,116.00 €, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datën 19.03.2021, respektivisht për 558 ditë të pranisë në punë, si dhe 70 % të shpenzimeve të udhëtimit në lartësi prej 546.84€, për relacionin e udhëtimit Malishevë-Gjilan dhe Gjilan – Përlepnicë dhe anasjelltas, duke e llogaritur kamatën prej 8% nga data 18.02.2020 /data e ushtrimit të padisë/ e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor.

II. Detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit, që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 270 €, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësja A. Z nga fshati ..., Komuna e Gjilanit, përmes përfaqësuesit të saj me autorizim Milot Spahiu avokat nga Gjilani, në këtë Gjykatë ka ushtruar padi duke e ndryshuar atë në aspektin e lartësisë së kërkesave ndaj të paditurës Komuna e Gjilanit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 210.50 €, në emër të shpërblimit jubilar si dhe në emër të kompensimit të shujtave të ushqimit në lartësi prej 1,116.00 €, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datën 19.03.2021, respektivisht për 558 ditë të pranisë në punë, si dhe 70 % të shpenzimeve të udhëtimit në lartësi prej 546.84€, për relacionin e udhëtimit Malishevë-Gjilan dhe Gjilan – Përlepnicë dhe anasjelltas, duke e llogaritur kamatën prej 8% nga data 18.02.2020 /data e ushtrimit të padisë/ e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi,

nën pasojat e përmbartimit të dhunshëm ligjor. Përfaqësuesi i paditëses ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës duke i specifikuar ato në lartësi prej 270€.

Përfaqësuesi me autorizim i të paditurës, në përgjegjje në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar me ligj, duke theksuar se Gjykata Themelore në Gjilan nuk ka kompetencë lëndore për të gjykuar rastin, meqë e kompetencës lëndore është Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative e poashtu ka theksuar se Komuna e Gjilanit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, meqë nënshkruet të Kontratës së lartëcekur janë MASHT-i/ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë/ dhe SBASHK-u/ Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës/ dhe se kontrata kolektive nuk prodhon efekte juridike për të paditurën, ngase e paditura nuk është nënshkruese e Kontratës. Poashtu përfaqësuesi i të paditurës konsideron se kemi parashkrim të kërkesave ngase ato janë ushtruar për realizim pas afatit ligjor prej 3 vite të ëprcaktuar në nenin 78 të Ligjit të Punës i Kosovës.

Gjykata analizoi secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku si në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe vërtetoi se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar me ligj, ashtu që Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të Aktgjykimit duke e detyruar të paditurën Komuna e Gjilanit që paditëses t'ia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 210.50 €, në emër të shpërblimit jubilar, për 10 vite përvojë të punës, në emër të kompensimit të shujtave të ushqimit në lartësi prej 1,116.00 €, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datën 19.03.2021, respektivisht për 558 ditë të pranisë në punë, si dhe 70 % të shpenzimeve të udhëtimit në lartësi prej 546.84€, për relacionin e udhëtimit Malishevë-Gjilan dhe Gjilan – Përlepnicë dhe anasjelltas, duke e llogaritur kamatën prej 8% nga data 18.02.2020 /data e ushtrimit të padisë/ e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbartimit të dhunshëm ligjor.

Kërkesat e paditëses bazën ligjore e kanë në nenin 35, paragrafi 8.4 i Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë / *Kontrata nr. 24 e dt. 18.04.2017/* ngase në nenin përkatës në mënyrë shprehimore është përcaktuar se „ *Punëtorët (antarë të SBASHK-ut) në vitin jubilar të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënsi i fundit, në vlerë: për 10 vite të përvojës së punës shpërblimin 50% të një page bazë, për 20 vite të përvojës së punës shpërblimin 75% të një page bazë ..., kurse në bazë të nenit 35.parag 7 të Kontratës, në mënyrë shprehimore është përcaktuar se „të punësuarve,u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompenzimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është dy /2/ € për të punësuarit që kanë mardhënie e punës primare në institucionet arsimore,,e poashtu i kompenzohen edhe shpenzimet e udhëtimit për 70% të tyre.*

Në fakt në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësja është mësimdhënëse tek e paditura, pasi që këtë fakt e konfirmon Kontrata e Punës me numër prot.720 e datës 01.09.2015, kurse përvoja e punës mbi 10 vjeqare tek e paditura /e cila kontestohet nga e paditura/ vërtetohet nga përmbajtja e vërtetimit nr. 231 i datës 06.02.2020, ku ceket se paditësja ka filluar punën tek e paditura me datë 01.09.2009, që do të thot se në momentin e shqyrtimit të padisë dhe kërkesave të saj, paditësja ka mbi 10 vite të punës, kurse nga Lista e Pagesave të Pagave e lëshuar nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës, konstatohet se paga bazë e paditëses është 421€, andaj meqë paditësja ka përvojë të punës mbi 10 vjeqare, Konform Kontratës Kolektive të Arsimit asaj i takon 50% i kësaj page në lartësi prej 210.50€

Në bazë të Vërtetimit nr. ... të dt. 19.03.2021 të lëshuar nga SH.F.M.U. ,, Skënderbeu,, në fshatin Përlepnice, Gjykata vërteton se paditësja deri me këtë datë ka 558 ditë të pranisë në punë dhe se asaj i takojnë shpenzimet e ushqimit nga dy/2/ euro në ditë që në total kapin shumë prej 1,116.00 €, kurse në bazë të Vërtetimit të datës 21.02.2020 të lëshuar nga NTSH ,, Përlepnica Trans,, dhe kuponave fiskal të dorëzuar nga kjo kompani, Gjykata vërteton se bileta e udhëtimit në relacionin Malishevë- Gjilan dhe Gjilan Përlepnice është nga 0.40€ që do të thotë 0.80€ për një drejtim dhe anasjelltas është 1.60€ dhe kur kjo llogaritet në 70% e shpenzimeve të udhëtimit për këtë periudhë kohore nga data 18.04.2017 e deri me datë 19.03.2021, del se e paditura duhet t'ia kompenzojë këto shpenzime paditëses në lartësi prej 546.84€.

Në bazë të Certifikatës së Vendbanimit me numër serik B ... të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjilan, konfirmohet fakti se paditësja jeton në fshatin ..., Komuna e Gjilanit dhe se për të shkuar në fshatin Përlepnice Komuna e Gjilanit ajo udhëton në dy relacione, fillimisht Malishevë – Gjilan dhe pastaj Gjilan – Përlepnice dh anasjelltas.

Në bazë të formularit të ankesave të datës 24.02.2020 të lëshuar nga e paditura gjykata konstaton se paditësja me kërkesë ju ka drejtuar të paditurës për përmbushjen e këtyre detyrimeve.

Kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse mbeten faktet nëse kjo gjykatë ka kompetencë lëndore për të gjykuar rastin, pastaj nëse kontrata kolektive e lartëcekur prodhon efekte juridike për të paditurën, meqë nuk është nënshkruar nga ana e saj dhe nëse kemi parashkrim të kërkesave konform nenit 87 të Ligjit të Punës/ Ligji nr.03/L-212 i datës 01. Nëntor 2010/.

Lidhur me pretendimet e të paditurës gjykata arsyeton se është e kompetencës lëndore për të gjykuar rastin, pasi që sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Gjykatat e Rregullta/ Ligji nr. 06/L - 054 në nenin 12.1 decidivisht është përcaktuar se „Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe. Kurse Departamenti për Qështje Administrative në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, sipas nenit 17 të Ligjit për Gjykatat gjykon qështjet administrative, respektivisht gjykon sipas padisë për hapjen e konfliktit administrativ, kur kemi një vendim administrativ të formës së prerë ndaj të cilit pala e pakënaqur ushtron padi me qëllim të realizimit të së drejtës së tij subjektive apo kur kemi të bëjmë me heshtje të administratës dhe për kategoritë e punëtorve që sipas nenit 4 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës/ Ligji Nr. 03/L-149/ mardhënia juridike e të cilëve rregullohet me këtë Ligj, të cilët sipas nenit 82 të Ligjit ndjekin procedurën e realizimit të së drejtës së tyre së pari në Komisionin për Ankesa dhe Parashkrim, pastaj i drejtohen Këshillit të Pavarur Mbikqyrës e mëpastaj me padi i drejtohen Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamentit për Qështje Administrative për hapjen e Konfliktit Administrativ, kurs siq dihet të punësuarve në sektorin e arsimit ju garantohet mbrojtje ligjore konform Ligjit të Punës së Kosovës.

Gjykata konsideron se nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesave, konform nenit 87 të Ligjit të Punës, ngase Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017, kurse padinë e ka ushtruar me datë 18.02.2020, qka do të thotë se të drejtën e saj e ka ushtruar mbrenda afatit prej 3 vite edhe pse neni 87 i Ligjit të Punës është i paqartë kur, citoj ,, *Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës,* që do të thotë parashkrimi fillon të rrjedhë nga dita e ushtrimit të kërkesës e jo siq duhet të ishte nga dita e ardhjes për pagesë/ maturimi i kërkesës/ të qdo kërkesë.

Poashtu, nuk qëndron pretendimi i të paditurës se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk prodhon efekte juridike ndaj të paditurës për shkak se e njëjta nuk është nënshkruese e saj, pasi që konform nenit 2 të Kontratës, dispozitat e saj gjejnë zbatim edhe për Komunitat apo DKA-të.

Detyrimi i të paditurës për pagesën e kamatës dhe kamatëvonesës prej 8% në vit është gjykuar nga Gjykata konform nenit 382 të LMD/ Ligji nr. 04/L-077 i datës 10 maj 2012, në të cilën dispozitë është përcaktuar se „ *Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. 2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.*

Ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës, Gjykata e bazoi në nenin 452.1 të LPK-së, duke marrur parasysh suksesin e paditëses në kontest, ashtu që e detyroi të paditurën që t’ia kompenzoj paditëses shpenzimet në lartësi prej 270€, në afat prej 7 ditë pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi edhe ate për përpilimin e padisë shumen prej 104€, taksë gjyqësore në lartësi prej 31€ dhe për një përfaqësim gjyqësor të avokatit 135€, konform Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës

Nga të cekurat më lartë, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të Aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr.1012/2020 date 26.03.2021

G j y q t a r i
Berat Spahiu

Udhëzim mbi Mjetin Juridik: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditësh, pas ditës së pranimit, përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2020:050972
Datë: 29.03.2021
Numri i dokumentit: 01642365